



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim C-A

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore: 15 leksione, 65 seminare/ushtrime

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti II/ semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master II në Përkthim teknik dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë është e ndërtuar në katër boshte kryesore: I – Dëgjimi aktiv dhe strategjia mnemoteknike bazë (ushtrime shqip-shqip ose frëngjisht-frëngjisht dhe më pas frëngjisht-shqip); II – Marrja e shënimeve; III. Konsolidimi i përvetësimit të interpretimit konsektiv nga gjuha frënge (C) drejt gjuhës shqipe (A). IV. Interpretimi simultan. Tema e ligjëratave të përzgjedhura për interpretim lidhet me çështjet kryesore të aktualitetit (ekonomia, politika, mjedisi, institucionet ndërkombëtare, cultura, etj.). Në auditor studentët përballen me ligjërata të hartuara nga pedagogu apo vetë ata si dhe me regjistrime audio ose video të oratorëve të ndryshëm.

Objektiva të përgjithshëm:

Të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat interpretative që studentët kanë përfutur gjatë studimeve të mëparëshme, ose në praktika të rastësishme në terren.

Objektiva të veçantë:

Studenti duhet:

Të përvetësojë mekanizmat logjike, teknike dhe profesionale të domosdoshme për të zhvilluar reflekset që nevojiten për analizën, trajtimin e mesazhit, memorizimin dhe rishprehjen e informacionit në një kontekst ndërkulturor dhe ndërgjuhësor në kombinimet gjuhësore B-A dhe A-B.